

## **Kosovë: Projekti Ekonomia Dixhitale e Kosovës (KODE)**

### **Konsultimi i Dytë Publik me Ofruesit e Rrjetit Publik Mobil për përgjethjen e palidhura në kuadër të Financimit të Infrastrukturës Dixhitale**

*Lëshuar më datë: 10.02.2021*

#### **HISTORIKU**

Qeveria e Kosovës (QeK) ka siguruar mbështetje në vlerë prej 20,7 Milion EUR nga Asociacioni Ndërkombëtar për Zhvillim (më tutje “Banka”) për projektin Ekonomia Dixhitale e Kosovës. Projekti KODE synon të përmirësojë qasjen në shërbime broadband (brezgjërë), me kualitet më të mirë dhe me shpejtësi të lartë në zonat e identifikuara për këtë projekt, dhe të ofroj qasje në burime të mësimin online, shërbime dhe tregje të punës për qytetarët, si dhe për institucionet publike e akademike.

Është paraparë që **Projekti të arrijë objektiven e tij zhvillimore përmes dy grupeve të aktiviteteve**: (1) zgjerimin e qasjes në Infrastrukturën dixhitale me shpejtësi të lartë dhe me kualitet më të mirë për qytetarët e Kosovës; dhe (2) mbështetjen për qytetarët e Kosovës për të përfituar nga mundësitë rajonale dhe globale që ofron Ekonomia Dixhitale (ED), veçanërisht për gjenerimin e të ardhurave, përdorimin e shërbimeve si dhe për edukim, në mënyrë që të nxitet rritja e ekonomisë dixhitale në Kosovë.

**KODE implementohet nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit (Ministria)** e cila siguron drejtim strategjik dhe mbikëqyrje teknike për të gjithë Projektin. Ministria është përgjegjëse për zhvillimin e sektorit të Teknologjisë Informative dhe Komunikuese (TIK) dhe e zbaton këtë mandat përmes Departamentit të Postë, Telekomunikacionit dhe Teknologjisë Informative e Komunikuese (Departamenti), i cili për qëllimet e projektit do të veprojë si Agjencia udhëheqëse për zbatim të projektit dhe do të bartë përgjegjësitë kryesore për të gjitha Komponentet e Projektit. Departamenti e zbaton projektin përmes Njesisë për Zbatimin e Projektit KODE (më tutje “KODE-PIU”) që për këtë qëllim është themeluar brenda Departamentit. **Projekti përbëhet nga tri komponentë**: I. Përfshirja dixhitale (Komponenti 1), II. Punët Dixhitale dhe Fuqizimi (Komponenti 2), dhe III. Përkrahje për zbatim të Projektit (Komponenti 3).

Ky konsultim publik ka të bëjë me identifikimin e përgjethjeve të palidhura në kuadër të Skemës së Granteve që është pjesë e Komponentës 1 të projektit (si nën-komponent 1.1) dhe është përshkruar më në detaje më poshtë.

Objektiva e kësaj Skeme të Granteve është të financojë projektet për shtrirjen e infrastrukturës brezgjërë dhe lidhjen e përgjethjeve mobile me këtë infrastrukturë.. Grantet do të jepen në bazë të procesit të përzgjedhjes konkurruese, transparente dhe jo-diskriminuese, duke respektuar parimin e neutralitetit teknologjik.

Në bazë të këtyre rregullave, Skema e Grantit do të ofroj grante për përfituesit e përzgjedhur. Grantet e dhëna janë të dedikuara për të mbuluar kostot e shpenzimeve të pranueshme, siç është vendosja e infrastrukturës brezgjere pasive dhe aktive dhe punët ndërtimore. Shuma e grantit mund të mbulojë deri në tetëdhjetë për qind (80%) të buxhetit të përgjithshëm të projektit (vetëm të shpenzimeve të pranueshme). Pjesa e mbetur e buxhetit të projektit duhet të mbulohet nga përfituesi i përzgjedhur. Me pranimin e grantit, përfituesi i përzgjedhur do të marrë përsipër një grup të obligimeve të përcaktuara. Termat dhe kushtet e grantit të dhënë, përfshirë detyrimet, do të përcaktohen nga Marrëveshja e Grantit.

Marrëveshjet për zbatimin e Skemës së Granteve janë përcaktuar në Manualin e Operimit të Granteve (pjesë e Manualit të Operimit të Projektit), i cili është i publikuar në uebsajtin e projektit **KODE**.

Pjesa fillestare dhe shumë e rëndësishme e Skemës së Granteve është identifikimi përgjigjeve të palidhura që do të adresohen përmes Projektit Sipas Manualit të Operimit të Granteve, procesi i identifikimit kalon përmes tri fazave: (1) Shqyrtimi nga zyra e informatave në dispozicion; (2) Kontrolli në terren; dhe (3) Konsultimi me ofruesit e rrjetit publik mobil. Procedura e plotë për identifikim, validim dhe konfirmim është përshkruar në seksionin 1.2 të Manualit të Operimit të Granteve. Deri më tani, Ministria ka kryer dy fazat e para të procesit për identifikimin e përgjigjeve të palidhura dhe tani faza e tretë me Konsultimet Publike mendohet të përfundojë identifikimin përmes konsultimeve me përfituesit potencial (ofruesit e rrjetit publik mobil).

Për përgjigjet e palidhura të konfirmuara, Ministria përmes Skemës së Granteve, do të ofroj grante për përfituesit që të shtrijnë infrastrukturën brezgjere me shpejtësi të lartë në përputhje me proceset dhe procedurat e përcaktuara në Manualin e Operimit të Granteve dhe Thirrjes për Aplikime (të Granteve).

## **I. QËLLIMI I KONSULTIMIT**

Qëllimi i këtij konsultimi publik është që të vërtetoj nëse ofruesit e rrjetit publik mobil kanë plane konkrete (të aprovuara) që të shtrijnë infrastrukturën e tyre deri te përgjigjet e palidhura (të listuara në Tabelën 1, në seksionin III të këtij dokumenti) në 3 vitet e ardhshme nga momenti i publikimit të këtij konsultimi.

## II. INFORMATAT PËR PIRGJET E PALIDHURA TË PARA-IDENTIFIKUARA

Pirgjet e para-identifikuar janë pirgjet që nuk janë të lidhura me infrastrukturë fikse të komunikimeve elektronike.

Gjate procesit të identifikimit të pirgjeve të palidhura, Ministria ka para-identifikuar një numër të caktuar të tyre. Para-identifikimi i këtyre pirgjeve është bazuar në informacionet e grumbulluara nga ofruesit e rrjetit publik mobil, nga Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP) dhe poashtu nga informacionet e mbledhura prej stafit të Ministrisë, gjatë vizitave në terren (gjatë muajit Qershor 2020 – Janar 2021).


Pirgjet e palidhura të para-identifikuara, që janë të listuara në tabelën e mëposhtme, do të shpallen në Thirrjet e rradhës si nën-projekte.

*Tabela 1. Pirgjet e palidhura të para-identifikuara dhe lokacionet e tyre*

<b>Nr.</b>	<b>Vendndodhja e pirgjeve</b>	<b>Komuna</b>
1	Rrenc	Dragash
2	Strezoc	Kamenicë
3	Keçekollë	Prishtinë
4	Prapashticë	Prishtinë
5	Shtërpcë	Shtërpcë
6	Smallushë	Lipjan
7	Parallovë	Novobërdë
8	Zym	Prizren
9	Zatriq	Rahovec
10	Stranë	Mitrovicë
11	Leçinë	Skenderaj
12	Polac	Skenderaj
13	Bokshiq	Klinë
14	Preloci	Skenderaj
15	Buzovik	Viti
16	Graçanicë	Graçanicë
17	Marali	Malishevë
18	Muçibabë	Gjilan
19	Grizimë	Kamenicë
20	Dumnicë e Poshtme	Podujevë
21	Reçan	Suharekë
22	Dramjak	Ferizaj
23	Pjetërshan	Gjakovë

Përveç kësaj, lokacioni gjeografik i pirgjeve të lidhura të para-identifikuara është dhënë në figurën e mëposhtme.

Figura.1 Harta e pircjeve te palidhura të para-identifikuara.



Note: Vendndodhja e pircjeve të para-identifikuara

**Pirgu i para-identifikuar do të konsiderohet i konfirmuar (ose i identifikuar)** nëse gjatë këtij konsultimi publik, ofruesit e rrjetit publik mobil nuk do të ofrojnë informacione të dëshmuara në përputhje me kërkesat e mëposhtme për planet e tyre konkrete (të aprovuara) për lidhjen me infrastrukturë fikse brezgjere të pargjeve të para-identifikuara brenda 3 (tre) viteve të ardhshme. Kjo infrastrukturë duhet të jetë së paku e njejtë ose të tejkalojë parametrat e kualitetit teknik të synuar të infrastrukturës (nga Projekti).

Nëse pas këtij konsultimi publik secili prej pargjeve do të konfirmohet si e palidhur, nën-projektet që përfshijnë këto zona do të përfshihen në kuadër të Thirrjeve të radhës për Aplikime në Skemën e Grantit.

**Në rast se një ofrues i rrjetit publik mobil ka plane konkrete (të aprovuara) për lidhjen e pargjeve të para-identifikuara, gjatë periudhës së konsultimeve publike duhet të dorëzoj një Deklaratë të Interesit që lidhet me pargun specifik të para-identifikuar.** Deklarata Interesit duhet të dorëzohet me shkrim, e nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i ofruesit të rrjetit publik mobil dhe të përmbajë së paku: (a) një plan biznesi të besueshëm dhe dokumente mbështetëse si marrëveshjet e kredisë bankare; (b) një plan detal kalendarik duke përfshirë skicat, afatin kohor, prania e POP (Pika e Prezencës), teknologjia, topologjia e rrjetit etj. (c) konfirmim se investimi do të filloj brenda 12 muajve nga data e dorëzimit të Deklaratës së Interesit, dhe se lejet e ndërtimit janë marrë për shumicën prej të drejtave të shtegut të domosdoshme për projekt; dhe (d) një plan raportues mbi progresin e arritur dhe për zotimet e planit të veprimit që duhet të arrihen gjatë periudhës 3-vjeçare. Këto dëshmi duhet të tregojnë se do të bëhet përparim i rëndësishëm në aspektin e mbulimit brenda **periudhës 3-vjeçare** të parashikuar për investimin e mbështetur. Në këtë drejtim, një ofrues i rrjetit publik mobil duhet të jetë në gjendje të dëshmoj se brenda periudhës 3-vjeçare do të mbulojë pargun në fjalë.

Duke pasur parasysh kërkesat e mësipërme, Ministria dhe ofruesit e rrjetit publik mobil do të pajtohen, për një plan të veprimit për të monitoruar progresin e investimit për çdo periudhë 6-mujore dhe Ministria do të përjashtojë pargjet e para-identifikuara më parë nga lista e pargjeve të para-identifikuara.

---

#### **IV. AKTIVITETET E PROJEKTIT PËR LIDHJEN E PIRGJEVE TË IDENTIFIKUARA**

Aktivitetet e projektit për lidhjen e pircjeve të identifikuara (konfirmuara), do të fillojnë pas përfundimit të afatit të këtij konsultimi publik në rast se nuk do të dorëzohet Deklarata e Interesit.

Në rast se, pranohet Deklarata(t) e Interesit për një ose më shumë pircjeve të para-identifikuara, Ministria do të analizoj Deklaratën dhe do të marr vendim për secilën prej tyre. Aktivitetet e projektit do të vazhdojnë me nën-projekte (LOT) për pircjet e mbetura të identifikuara siç është specifikuar në tabelën e mësipërme.

Të gjitha informacionet relevante rreth Thirrjeve për Aplikime do të publikohen në ueb faqen e projektit KODE pas përfundimit të periudhës së konsultimit publik sipas afateve të përcaktuara në këtë dokument.

#### **V. OFRIMI I PËRGJIGJES DHE DATA E MBYLLJES SË KONSULTIMIT PUBLIK**

Ofruesit e rrjetit publik mobil të interesuar ftohen të dërgojnë komentet me shkrim duke përfshirë Deklaratën e Interesit, jo më vonë se **18 shkurt 2021** në adresën e mëposhtme apo në e-mailin më poshtë.

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit (MEA)

Rr. Nënë Tereza nr.36.

Kati I, Zyra Nr.112

10000, Prishtine, Kosovë.

email: [mzhe.tik@rks-gov.net](mailto:mzhe.tik@rks-gov.net)

website: <https://kodeproject.org/>

Lëshuar më: **10 shkurt 2021**.

---